

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pse Shqipëria nuk është më strehë e sigurt për paratë e “Çunave të Londrës”, Daily Mail zbulon konfiski met
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/pse-shqiperia-nuk-eshte-me-strehe-e-sigurt-per-parate-e-unave-te-londres-i585820
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 14:02:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 14:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	589a4b49a5daae5753d089d1b4b0d27829d16d8c345e9b5b7833370807f7eb53
TEKSTI	b4c718aa20978e4080eaaafd79625a95b3191733d53d41ebe6488dacd2613719e
PAMJA	a1cecf599ba1ef1a74620975b6342fc8fe0807cf395537fa4ff5ea065ac8e18

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	92c232194643676010a5c96a201ee98af0c4368a35272e9241c242282bc05cd5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	cefaef77fae8127be4f6b3fffc05035f4622ba050d1097e673137ff6e41f5a68
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/92c232194643676010a5c96a201ee98af0c4368a35272e9241c242282bc05cd5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Pse Shqipëria nuk është me strehe e sigurt për paratë e “Çunave të Londrës”, Daily Mail zbulon konfiskimet”Patriotizmi sot paska pushim”/ Perparim Rama ironizon Vet fundit

Pse Shqipëria nuk është më strehë e sigurt për paratë e “Çunave të Londrës”, Daily Mail zbulon konfiskimet



13 Shtator 2026, 16:00Kronika TEMA



Gazeta britanike Daily Mail i ka kushtuar një reportazh të gjatë të ashtuquajturve “Çunat e Londrës”, duke u fokusuar te mënyra se si ata investojnë në Shqipëri paratë e siguruar në Angli përmes trafikut të kokainës dhe kultivimit të kanabisit në shtëpi bari.

Tom Kelly, editor i investigimeve në këtë gazetë thotë se “paratë investohen edhe në ndërtimin e hoteleve luksoz të cilat frekuentohen edhe nga ata 1 milion turistët britanik të cilët zgjedhin të vizitojnë Shqipërinë çdo vit.

Në artikull të cilit i referohet Top Channel, evidentohet edhe përpjekja e SPAK në sekuestrimin e pronave me burim kriminel e organizuar shqiptarë në Britaninë e Madhe si dhe një marrëveshje mes palës angleze dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Kjo marrëveshje parashikon se pronat e konfiskuara në Shqipëri apo Angli të shtetasve shqiptarë, pasi të jenë shitur do të ndahen 50 me 50 mes dy vendeve.

Daily Mail ndalet në rolin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara zyrat e të cilës janë në një pronë të konfiskuar të një individi i dënuar për prostitucion.

Risena Xhaja, drejtuesja e Agjencisë të Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i tregoi gazetës Daily Mail një katalog, të përgatitur posaçërisht, ku paraqiten rreth 2,500 prona dhe pasuri me vlerë mbi 28 milionë euro, të cilat prokurorët i kanë sekuestruar gjatë dekadës së fundit, pasi dyshohet se janë blerë me para që rrjedhin nga aktiviteti kriminal.

Mes pasurive të sekuestruara përfshihen një sërë hotelesh të shtrenjta, vila, komplekse turistike pranë detit dhe apartamente bregdetare në të gjithë vendin.

Një hotel i konfiskuar iu dha Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë, në mënyrë që oficerët ta përdorin për pushime dhe konferenca trajnimi.

Ndërsa një pronë në Tiranë tashmë është shndërruar në një galeri publike.

Të tilla konfiskime janë komentuar nga Risena Xhaja si të rëndësishme.

Të dhënat e Agjencisë Shqiptare të Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara tregojnë se deri në qershor 2026 janë sekuestruar 2500 asete me vlerë mbi 28 milion euro.

Janë 514 asete të konfiskuara vlera të cilave shkon në mbi 6.5 milion euro.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

14:41 Kronika / 2 komente

[Kërcënoi kushëririn dhe familjen për 300 mijë euro, arrestohet 56-vjeçari në Vorë](#)

13:40 Kronika

[Nuk justifikoheshin me të ardhurat, sekuestrohen 3 automjete luksoze në Vlorë, nis hetimi pasuror ndaj drejtuesve](#)

11:35 Kronika / 8 komente

Të shtëna me armë në Mat, gjendet një makinë e djegur në Urakë

10:10 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.